



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 26

2001

Maj

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Udhëzim i KQZ nr. 35, datë 18.5.2001	Për orarin e punës së Komisioneve të Zonave Zgjedhore dhe Komisioneve të Qendrave të Votimit.....	805
Udhëzim i KQZ nr. 36, datë 21.5.2001	Për caktimin e numrit dhe vendndodhjes së qendrave të votimit.	806
Udhëzim i KQZ nr. 37, datë 22.5.2001	Për kryerjen, evidentimin dhe mënyrën e likuidimit të shpenzimeve nga KZQV-të / KZZ-të.....	807
Udhëzim i KQZ nr. 38, datë 22.5.2001	Për tërheqjen e kandidatit nga konkurimi për raundin e dytë të zgjedhjeve.....	812
Udhëzim i KQZ nr. 39, datë 26.5.2001	Për propozimin e caktimit të sekretarëve të Komisioneve të Zonës Zgjedhore.....	812
Udhëzim i KQZ nr. 41, datë 29.5.2001	Për përcaktimin e afateve kohore për pranimin e dokumentacionit të kandidatëve për deputetë nga KKZ-ja.....	813

U D H Ë Z I M
Nr. 35, datë 18.05.2001

**PËR ORARIN E PUNËS SË KOMISIONEVE TË ZONAVE ZGJEDHORE DHE
KOMISIONEVE TË QENDRAVE TË VOTIMIT**

Në mbështetje të nenit 18 pika 1 dhe 3 dhe të nenit 32 pika 7 të ligjit nr.8609 datë 8.5.2000 “Për Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë”, Komsioni Qendror i Zgjedhjeve

U D H Ë Z O N:

1. Komisionet e Zonave Zgjedhore funksionojnë si organe te përhershme edhe për periudhën kohore pasi ka mbaruar procesi zgjedhor.

Për këtë periudhë, anëtarët e KZZ-së paraqiten në punë një herë në muaj, ditën e shtunë të javës së dytë të çdo muaji, nga ora 8 00 deri 12 00. Për punën e kryer kryetari, zëvendëskryetari dhe anëtarët e komisionit përfitojnë një shpërblim. Masa e shpërblimit përcaktohet me vendim të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

2. Për zgjedhjet për Kuvendin për vitin 2001, në periudhën nga mbledhja e parë e krijimit të KZZ-ve deri më datën 23.6.2001, orari i punës së komisioneve të Zonës Zgjedhore të jetë nga ora 8 00 deri 12 00 dhe nga ora 16 00 deri 20 00, kurse për periudhën nga data 24.6.2001 deri në dorëzimin e tabelave të rezultateve në KQZ, orari i punës së Komisioneve të Zonës Zgjedhore të jetë nga ora 6 00 deri 24 00.

3. Kur në Zonat Zgjedhore ka raund të dytë zgjedhjesh, për periudhën nga data 27.6.2001 deri më datë 7.7.2001, orari i punës së Komisioneve të Zonave Zgjedhore të jetë sipas përcaktimit të bërë në pikën 2 të këtij udhëzimi, kurse më datën 8.7.2001 e deri në dorëzimin e tabelave të rezultateve dhe kutive të votimit në KQZ, orari i punës së Komisioneve të Zonave Zgjedhore të jetë nga ora 6 00 deri 24 00.

4. Gjatë periudhës së kohës nga mbledhja e parë e Komisionit të Zonave Zgjedhore e deri në dorëzimin e tabelave të rezultateve dhe kutive të votimit në KQZ, përfshi këtu edhe periudhën kohore të votimit për raundit e dytë të zgjedhjeve në ato zona ku do të ketë të tilla, kryetari, zëvendëskryetari dhe anëtarët e komisionit i shkëpusin përkohësisht marrdhëniet e punës që kanë me punëdhënësit me kohë të plotë pune dhe punojnë në zyrën e caktuar për KZZ.

5. Kryetarit, zëvendëskryetarit dhe anëtarëve të KZZ-së, për periudhën që janë në procesin zgjedhor, u ruhet vendi i punës dhe marrdhëniet financiare të vazhdojnë rregullisht si më parë, pranë punëdhënësve të tyre.

6. Anëtarët e KZZ-ve, për periudhën që punojnë sipas kohës së punës të përcaktuar në këtë udhëzim, shpërblehen në përputhje me masën që caktohet me vendim të KQZ-së.

7. Orari i punës për Komisionet e Qendrave të Votimit, nga mbledhja e parë deri në datën 23.6.2001 të jetë fakultativ, në varësi të detyrave dhe udhëzimeve të dhëna nga KZZ-ja, nga kryetari apo zëvendëskryetari i KQV-së. Nga data 23.6.2001 deri më datën 24.6.2001 orari i punës të jetë nga ora 8 00 deri 12 00 dhe nga ora 16 00 deri në ora 20 00. Nga data 24.6.2001 deri më datën e dorëzimit me proceverbal të tabelave të rezultateve dhe kutive të votimit në KZZ-në përkatëse, orari i punës të jetë nga ora 7 00 dhe vazhdon pa ndërprerje deri më datën 25.6.2001, ora 18 00.

8. Në rast balotazhi në zonën përkatëse, KQV-të vazhdojnë të funksionojnë me orarin e përmendur në pikën 7 të këtij vendimi për datat 7, 8 dhe 9 korrik 2001.

9. Për punën e kryer, kryetari, nënkryetari dhe anëtarët e KQV-ve përfitojnë një shpërblim. Masa e shpërblimit përcaktohet me vendim të KQZ-së.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ilirian Celibashi

U D H Ë Z I M
Nr. 36, datë 21.5.2001

PËR CAKTIMIN E NUMRIT DHE VENDNDODHJES SË QENDRAVE TË VOTIMIT

Në mbështetje të nenit 35 pika 2, 41, 47, 91 dhe 92 të ligjit nr.8609 datë 8.5.2000 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

U D H Ë Z O N:

Për ngritjen e qendrave të votimit, caktimin e numrit dhe vendndodhjen e tyre, KZZ- të në bashkëpunim me KZQV-të dhe kryetarin e bashkisë apo komunës përkatëse, do të procedojnë si vijon:

1. Në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të 24 qershorit 2001 do të përdoret i njëjti numër i qendrave të votimit që u përdor në zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore të 1 tetorit 2000.

2. Shtesa të qendrave të votimit do të bëhen vetëm për qendrat studentore (konviktet) të universiteteve, një qendër votimi për jo më pak se 800 dhe jo më shumë se 1000 votues.

3. Nisur nga fakti që një zonë zgjedhore për deputetët përfshin më shumë se një bashki apo komunë, renditja do të realizohet sipas renditjes së bashkive, komunave ose lagjeve në tabelën e ligjit nr.8746 datë 28.2.2001 “Për caktimin e zonave zgjedhore”, e cila veças për çdo zonë zgjedhore iu dërgohet së bashku me modelin 29 të vendimit të KZZ-së “Për caktimin e vendndodhjes së qendrave të votimit”, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

4. Në spitale, burgje, vende paraburgimi ngritja e KQV-ve dhe qendrave të votimit bëhet si rregull në të njëjtin numër që u ngritën për zgjedhjet e 1 tetorit 2000. Nëse pas tetorit 2000 është ndërtuar ndonjë institucion i ri i kësaj natyre, atëherë duhet parashikuar edhe një qendër votimi shtesë.

5. Për caktimin e vendndodhjes së qendrave të votimit do të procedohet si vijon:

-Qendrat e votimit, si rregull, caktohen në objekte publike, si shkolla, konvikte, kopshte, çerdhe, ambulanca, qendra shëndetësore apo kulturore etj. të kësaj kategorie.

-Kur në territorin e zonës së qendrës së votimit nuk ka objekte si ato të përmendura më lart, KZZ-ja vendos t'i propozojë KQZ-së krijimin e qendrës së votimit në një objekt privat (orientuar si rregull nga i njëjti numër i përdorur në zgjedhjet e 1 tetorit 2000) dhe, me marrjen e konfirmimit zyrtar nga KQZ-ja, shpallet vendndodhja dhe ngrihet qendra e votimit.

Në plotësimin e kësaj detyre, KZZ-të duhet të mbajnë parasysht që vendndodhja e qendrës së votimit, si rregull, të jetë e njëjtë me atë të përdorur në zgjedhjet e 1 tetorit 2000.

Mbi bazën e procedurave të përcaktuara në këtë udhëzim, KZZ-ja merr vendim sipas modelit 29 të dokumenteve të miratuar nga KQZ-ja, si dhe shpall vendndodhjen e qendrës së votimit sipas modelit 29/1.

5. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ilirian Celibashi

U D H Ë Z I M
Nr. 37, datë 22.05.2001

**PËR KRYERJEN, EVIDENTIMIN DHE MËNYRËN E LIKUIDIMIT TË SHPENZIMEVE
NGA KZQV-TË/KZZ-TË**

Në mbështetje të nenit 18 të ligjit nr.8609 datë 8.5.2000 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

U D H Ë Z O N:

Për evidentimin dhe përballimin e shpenzimeve të rishikimit të listave dhe procesin zgjedhor, mbështetur edhe në marrëveshjen e bashkëpunimit të nënshkruar midis Qeverisë dhe Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, do të procedohet si vijon:

A. Organet shtetërore dhe ato të qeverisjes vendore kanë detyrimin të sigurojnë pa pagesë:

1. Ambientet e punës, si dhe orenditë e nevojshme, tavolina, karrike dhe kasaforta për KZZ-të/ KZQV-të.

2. Ambientet e nevojshme për qendrat e votimit, si rregull, do të sigurohen në objekte të përdorimit publik (shkolla, kopshte, institucione kulturore, çerdhe, ambulanca apo qendra shëndetësore etj). Në rast të mungesës së këtyre institucioneve KZZ-të / KZQV-të me miratim zyrtar të KQZ-së, mund të vendosin qendrën e votimit në një ambient privat, kundrejt pagesës, masa e të cilës përcaktohet me vendim të veçantë nga KQZ-ja.

3. Ruajtjen e ambienteve të punës si dhe ndërlidhjen telefonike së bashku me aparatën, për çdo KZZ-të / KZQV-të.

B. Shpenzime që do të përballohen nga buxheti i zgjedhjeve të KQZ-së

Shpërblimi i komisioneve zgjedhore:

1. Shpërblimi i anëtarëve të KZZ-ve, KZQV-ve përfshi dhe sekretarët përkatës, kryhet në masën e caktuar me vendim të veçantë të KQZ-së, si vijon:

a) në fund të procesit zgjedhor për periudhën kur përballojnë fushatë, apo të rishikimit të listave mbasi komisioni të ketë dorëzuar në KQZ me procesverbal, listat e rishikuara, gjithë dokumentet e procesit zgjedhor, kutitë e votimit të çdo qendre votimi si dhe çdo material që është i përdorshëm më shumë se një herë.

b) përpilon listëpagesën në të cilën do të përfshihen kryetari, zëvendëskryetari, anëtarët dhe sekretari sipas vendimit më të fundit të KQZ-së. Personat e emëruar dhe që gjatë procesit zgjedhor janë zëvendësuar mbi bazën e propozimeve të partive politike dhe vendimit përkatës të KQZ-së nuk shpërblehen.

c) shpërblimi do të merret mbas përfundimit të procesit zgjedhor apo rishikimit të listave i cili i përket punës së kryer për periudhën dy mujore.

2. Shpërblimi i anëtarëve të KQV-ve

Mbështetur në vendimin e veçantë të KZZ-së për çdo qendër votimi do të shpërblehen kryetari, zëvendëskryetari, anëtarët dhe sekretari, në masën që do të përcaktohet me vendim të KQZ-së. Listëpagesës në çdo rast i bashkëlidhet vendimi i emërimit të KQV-së. Të mbahet parasysh që edhe në këtë rast personat e zëvendësuar mbi bazën e propozimeve të partive politike dhe vendimit përkatës të KZZ-së nuk shpërblehen.

Shpërblimi i këtij komisioni do të bëhet pasi kryetari, zëvendëskryetari dhe sekretari të kenë paraqitur procesverbalin e dorëzimit në KZZ të tabelave të rezultateve, kutive të votimit dhe materialeve me përdorim të shumfishtë.

3. Shpërblimi i QRLZ-ve

Për kryerjen e shpërblimit të punonjësve të rishikimit në QRLZ-të është e domosdoshme të

disponohet vendimi i KZQV-së që emëron tre anëtarët e saj, vendim që i bashkëlidhet listëpagesës përkatëse; njëkohësisht duhet kontrolluar fakti që KZQV-ja i ka ngritur QRLZ-të konform Udhëzimit nr.25, datë 23.4.2001 dhe shkresës së KQZ-së nr.579/1, datë 4.5.2001.

Shpërblimi bëhet në masën e caktuar nga KQZ-ja, pas paraqitjes të procesverbalit të dorëzimit të listave, të rishikuara në KZQV-në përkatëse, dhe prej KZQV-së të jetë konfirmuar me shkrim se kanë dorëzuar në rregull edhe gjithë pajisjet e përdorura në ambientin e punës (inventarin e pajisjeve përfshi edhe apartin telefonik).

4. Shpërblimi i grupeve të verifikimit

Grupet treshe të verifikimit (përfshijë grupin treshe të verifikimit në rrugë partiake të listave të cilët nuk shpërblehen nga KQZ-ja) shpërblehen në masën e caktuar nga KQZ-ja. Listëpagesa duhet të ketë bashkëlidhur vendimin e KZQV-së për ngritjen dhe përbërjen e grupit të verifikimit.

5. Shpërblimi i punonjësve të zyrave të gjendjes civile

Shpërblimi bëhet në masën e caktuar në vendimin përkatës të KQZ-së. Listëpagesa përgatitet nga përgjegjësi i zyrës së gjendjes civile në rrethin përkatës për gjithë punonjësit e këtyre zyrave në organet e qeverisjes vendore të rrethit.

6. Evidentimi dhe likuidimi i shpenzimeve të tjera:

a) Shpenzimet telefonike

Në rastet kur në KZZ, KZQV ose në QRLZ është vendosur numri i ri telefonik, në faturën që vjen nga Telekomit, për periudhën që KZZ, KZQV dhe QRLZ kanë qenë në punë, përpara se të firmoset nga kryetari, zëvendëskryetari dhe sekretari i KZZ, KZQV-së mundësisht të shënohen dhe numrat me të cilët është biseduar (një nga numrat e KQZ-së ose numri apo numrat e supervizorit, kordinatorit në prefekturë etj.). Ky dokument do të paraqitet në prefekturë për t'u likuiduar nga KQZ-ja.

Në rastet kur telefoni i sekretarit të këshillit të bashkisë ose komunës, ose një numër tjetër telefonik i këtyre organeve ose i ndonjë institucioni tjetër shtetëror (jo celular) është vënë në dispozicion të KZZ, KZQV-së ose QRLZ - së do të vepohet si vijon:

Telekomit paraqet shpenzimet telefonike veças për çdo numër telefonik. Për periudhën që ka funksionuar KZZ-ja, KZQV-ja ose QRLZ-ja (nga data që ka bërë mbledhjen e parë e deri më datën 31.5.2001), në këtë faturë përpara se të firmoset nga kryetari, zëvendëskryetari dhe sekretari i KZZ, KZQV-së (edhe për QRLZ-të) mundësisht të shënohen dhe numrat e telefonave me të cilat është biseduar, vuloset, dhe ky dokument do të dorëzohet në prefekturë dhe do të likujdohet nga fondet e KQZ-së për shpenzimet telefonike.

Në rastet kur nuk ka telefon dhe ka qenë e nevojshme të realizohej biseda telefonike përmes centraleve të Telekomit, merret fatura e bisedës së kryer ku të shënohet edhe numri telefonik me të cilin është komunikuar (një nga numrat e KQZ-së, ose numri apo numrat e supervizorit, kordinatorit etj. në prefekturë); çdo faturë e tillë kundërfirmohet nga kryetari, zëvendëskryetari, sekretari dhe vuloset me vulën e KZZ-së, KZQV-së dhe paraqitet për likuidim në prefekturë.

b) Shpenzime për fotokopjim listash

Për KZQV-të që sipas udhëzimit nr.25, datë 23.4.2001 dhe shkresës së KQZ-së nr.579/1 datë 4.5.2001 lejohen të ngrenë QRLZ do të evidentohen edhe shpenzimet për fotokopjimin, sipas këtij rregulli :

Lista 3 fotokopjohet totalisht në një kopje dhe ajo ndahet midis KZQV-së dhe QRLZ-ve, në varësi me numrin e qendrave të votimit të dhëna për rishikimin e secilës.

Lista 2 dhe 2/B fotokopjohet në aq kopje sa QRLZ janë ngritur. (Origjinali i dërguar nga KQZ-ja mbahet në KZQV)

Fotokopjimi realizohet me vendim të KZQV-së, si rregull, në një nga institucionet që kanë fotokopje, në pamundësi të kryhet në tregun e lirë. Për punën e kryer në tregun e lirë duhet të merret dokumenti i cili të tregojë numrin e fletëve që janë fotokopjuar, çmimin për çdo fletë (çmimi i fotokopjimit me shumicë) dhe vlerën gjithësej. Ky dokument firmoset dhe vuloset nga përfaqësuesi i

subjektit që ka kryer shërbimin, kundërfirmohet nga kryetari, zëvendëskryetari dhe sekretari i KZQV-së, si dhe vuloset me vulën e KZQV-së.

c) Shpenzime udhëtimi e diete

Anëtarëve të KZQV-së përfshi edhe sekretarin, që kanë marrë pjesë në seminarin trajnues është përcaktuar nga KQZ-ja t'u përballohen shpenzimet për udhëtim e dieta deri 1500 lekë për person. Listëpagesa do të hartohet dhe të kundërfirmohet nga trajnuesi dhe supervizori i angazhuar nga KQZ-ja. Pagesa do të kryhet nga fondet e zgjedhjeve të KQZ-së në prefekturë.

Për seminarin e trajnimit të KZZ-ve e më pas KQV-ve, trajnuesi dhe supervizori i KQZ-së paraqesin listën emërore mbi të cilën do të bëhet pagesa. Secili person në këtë listë duhet të përgatisë urdhërshërbimin sikundër përmendet më poshtë, dhe likuidimi i tyre do të bëhet sipas kriterëve të përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 320, datë 23.5.1998 për shërbimet deri më datë 7.5.2001 dhe pas kësaj date likuidimi do të bëhet në bazë të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 228, datë 13.4.2001. Pagesa do të kryhet nga fondet e zgjedhjeve të KQZ-së në prefekturë.

Për rastet kur një nga drejtuesit e komisionit, sekretari apo ndonjë anëtar janë thirrur nga KQZ-ja, Drejtoria e Komisioneve Zgjedhore apo supervizori i KQZ-së në prefekturë, për të marrë apo për të dorëzuar materiale për procesin e rishikimit të listave, për tërheqjen e materialeve të votimit etj. (si rregull maksimumi dy veta, dhe shërbimi dy deri tre herë) personat e thirrur duhet të përgatisin urdhërshërbimin (formati i zakonshëm që përdoret nga administrata shtetërore) ku të plotësohen gjithë ekstremitetet e kërkuara, përfshi edhe qëllimin konkret të shërbimit. Urdhërshërbimi të firmoset nga kryetari apo nënkryetari dhe të ketë vulën e KZQV-së KZZ-së. Shërbimet, si rregull, të jenë vajtje- ardhje brenda ditës dhe të shoqërohen me biletat e mjetit me të cilin ka udhëtuar.

Numri i rasteve që drejtuesit e KZZ-së thirren ose vijnë në KQZ për dorëzimin e tabelave të rezultateve të bazës materiale ose të problemeve të tjera që mund të dalin gjatë procesit të rishikimit të listave dhe atij zgjedhor, përcaktohen nga KQZ-ja. Në çdo rast, drejtuesit e KZZ-ve do të përgatisin e paraqesin urdhërshërbimin në prefekturë.

Dietat për periudhën e rishikimit të listave do të paguhen brenda kriterëve të përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.320, datë 23.5.1998 deri më datën 7.5.2001. Pas kësaj date, dietat paguhen sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.228, datë 13.4.2001.

d) Shpenzime kancelerie etj.

Për çdo KZQV lejohen jo më shumë se 1000 (një mijë) lekë shpenzime kancelerie kundrejt dokumenteve që vërtetojnë shpenzimin e kryer, dokumente të cilat duhet të kundërfirmohen nga kryetari, zëvendëskryetari dhe sekretari i KZQV-së si dhe vuloset me vulën e komisionit.

Shpenzime kancelerike nga KZZ-të dhe KQV-të nuk do të kryehen mbasi do të furnizohen me kanceleri direkt nga KQZ-ja me fillimin e punës.

Për caktimin e kufirit të zonës së qendrës së votimit brenda KZZ-së, si rregull, do të përdoren hartat ose skicat që u përdorën në zgjedhjet e tetorit 2000, të cilat ruhen nga sekretari i KZQV-së. Për bashkitë që për efekt pagash trajtohen si bashki të kategorisë së parë (mbi 40 000 votues), KZZ-të marrin një fotokopje të tyre për të bërë përmirësimet e mundshme. Për fotokopjimin do të procedohet sipas përcaktimit në pikën 6 (b) dhe likuidimi do të bëhet nga fondet e KQZ-së me pagesë të vonuar.

dh) Për transportin e materialeve të votimit

Materialet e votimit deri në prefekturë do të sillen me mjetet e mobilizuara nga KQZ-ja.

Shpërndarja nga prefektura në çdo KZZ do të bëhet me furgona të mobilizuar nga prefektura. Prefekturat në bashkëpunim me KZZ-në përkatëse, hartojnë grafikun-orar për shpërndarjen e bazës materiale, në mënyre që të minimizohet koha e dispozicionit të furgonave.

Pagesa për transportin e bazës materiale për furgonat do të jetë:

Për distancat nga 0-20 km vajtje-ardhje pagesa do të jetë 2000 lekë. Për distancat 21-30 km pagesa do të jetë 3000 lekë. Për distancat 30-40 km pagesa do të jetë 4000 lekë. Për distancat 40-50 km pagesa do të jete 4500 lekë. Për distancat 50-60 km pagesa do të jetë 5000 leke. Për distancat 60-

80 km pagesa do të jetë 6000 lekë dhe mbi 80 km pagesa do të jetë 7 500 lekë.

Për shpërndarjen dhe kthimin e bazës materiale nga KZZ në KQV dhe anasjelltas deri në distancën 5 km, pagesa e transportit të jetë 500 lekë për KQV. Distanca mbi 5 km do të paguhet 1000 lekë. Në të gjitha rastet, për çdo mjet, mbahet dokument ku të vërtetohet tipi, targa, shoferi, lloji i mallit dhe data e transportit, si dhe destinacioni. Ky dokument firmoset nga transportuesi, supervizori i KQZ-së në prefekturë, si dhe firma e vula e marrësit në dorëzim të mallit (kryetari, zëvendëskryetari dhe sekretari i KZZ-së). Likuidimi për çdo KZZ do të bëhet në prefekturë nga fondet e KQZ-së për zgjedhje.

Për rastin e transportit të kutive të votimit pas përfundimit të procesit të votimit nga KZZ-ja në KQZ, në varësi me numrin e kutive të votimit, zgjidhet tipi i mjetit dhe hartohet dokumenti sikundër u përmend më lart, i cili firmoset nga transportuesi, kryetari, zëvendëskryetari dhe sekretari i KZZ-së, duke vënë dhe vulën e KZZ-së.

7. Autoveturat që do të vihen në dispozicion për KZZ-të do të përdoren kundrejt furnizimit me tallona nga KQZ-ja.

8. Edukimi qytetar i votuesve është organizuar të bëhet në shkallë vendi përmes medias së shkruar dhe asaj elektronike; në këto kushte nuk duhet të bëhen shpenzime nga KZZ-të, në mediat lokale.

9. Gjithë dokumentet që trajtohen në këtë udhëzim para se të bëhet efektiv likuidimi i tyre duhet të kundërfirmohen edhe nga supervizori i KQZ-së dhe inspektori përkatës i Drejtorisë së Komisioneve Zgjedhore.

10. Fondet e çelura duhet të përdoren vetëm sipas destinacioneve të përcaktuara nga KQZ-ja, tepricat e mundshme duhet të mbeten gjendje dhe në përfundim të procesit do t'i rikthehen KQZ-së, sikundër edhe rastet që do të evidentohen shpenzime të pambuluara të cilat me vendim të veçantë të KQZ-së do të rimbursohen kundrejt dokumentacionit që do të paraqitet nga KZZ-ja.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ilirian Celibashi

U D H Ë Z I M
Nr. 38, datë 22. 05. 2001

PËR TËRHEQJEN E KANDIDATIT NGA KONKURIMI PËR RAUNDIN E DYTË
TË ZGJEDHJEVE

Në mbështetje të nenit 18 dhe 63 të ligjit nr.8609 datë 8.5.2000 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" Komsioni Qendror i Zgjedhjeve

U D H Ë Z O N:

1. Tërheqja e kandidatit të shpallur për konkurim në raundin e dytë të zgjedhjeve bëhet jo më vonë se 48 orë nga data e shpalljes së vendimit të KZZ-së.

Në rast tërheqjeje të kandidatit në raundin e dytë, do të konkurojë kandidati i renditur nga KZZ-ja i treti, e kështu me radhë. Tërheqja e këtyre kandidateve mund të bëhet jo më vonë se 8 ditë nga data e zgjedhjeve.

2. Në rast se kandidati i regjistruar për raundin e dytë të zgjedhjeve vdes përpara datës së caktuar për zgjedhjet, atëherë zgjedhjet ribëhen pas katër javësh.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ilirian Celibashi

U D H Ë Z I M
Nr. 39 datë 26.5.2001

(i azhornuar)
Ndryshuar me udhëzimin nr.40 datë 29.5.2001 (Pika 2)

PËR PROPOZIMIN E CAKTIMIT TË SEKRETARËVE TË KOMISIONEVE TË ZONËS
ZGJEDHORE

Në mbështetje të nenit 18 pika 1 dhe të nenit 32 pika 3 të ligjit nr.8609 datë 8.5.2000 “Për Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë”, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

U D H Ë Z O N:

1. Pas caktimit të kryetarit dhe zëvendëskryetarit të KZZ-së, nga KQZ-ja, kryetari dhe zëvendëskryetari i KZZ-së, organizojnë mbledhjen e KZZ-së, për shqyrtimin e kandidaturave për sekretar të komisionit.

2. Vendimi i KZZ-së për propozimin e sekretarit të komisionit, merret me konsensus. Kur konsensusi nuk arrihet atëherë, KZZ-ja i propozon KQZ-së, caktimin e sekretarit të komisionit me dy kandidatura alternative, të shoqëruara me CV-të përkatëse.

KQZ-ja cakton sekretar të komisionit, një nga dy kandidaturat e paraqitura.

3. Kandidati për sekretar të komisionit duhet të jetë jurist dhe nuk duhet të jetë përfaqësues apo drejtues i partisë politike apo grupimit politik në atë zonë.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ilirian Celibashi

U D H Ë Z I M
Nr. 41, datë 29.5.2001

PËR PËRCAKTIMIN E AFATEVE KOHORE PËR PRANIMIN E DOKUMENTACIONIT TË
KANDIDATËVE PËR DEPUTETËT NGA KKZ-JA

Në mbështetje të nenit 18 pika 1 dhe të nenit 79 të ligjit nr.8609, datë 8.5.2000 “Për Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë”, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

U D H Ë Z O N:

Kur një kandidat për deputet dorëzon në Komisionin e Zonës Zgjedhore dokumentacionin për regjistrimin si kandidat për atë zonë, KKZ-ja duhet ta shqyrtojë kërkesën e paraqitur brenda 24 orëve

nga data e paraqitjes së kësaj kërkesë, duke marrë vendimin përkatës. Kërkesa e paraqitur duhet të bëhet nga kandidati në përputhje me afatet kohore të parashikuara në nenin 76 pika 1 të Kodit Zgjedhor.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ilirian Celibashi

Fletorja Zyrtare gjendet:

- Në çdo njësi postare të çdo qyteti;
 - Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:
- Rr. Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

U dorëzua për shtyp më 31.5.2001
Doli nga shtypi më 31.5.2001

Tirazhi: 4100 copë

Formati: 60x88/8

Shtypshkronja "At Gjergj Fishta"
Tiranë, 2001

Çmimi: 100 lekë